



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-142

Prishtinë, më 27 janar 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 JANAR 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Jeton Svirca, Sreten Ivanoviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 janar 2014,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 janar 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 janar 2014.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 30 janar 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për hua dhe financim ndërmjet KFË Frankfurt Am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSST për përmirësimin e rrjetit të transmisionit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin gjeologjik të Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese,

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës,
13. Raporti i punës së Komisionit Ad- hoc për Reformën Zgjedhore,
14. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për zëvendësimin e anëtarit në komisionin parlamentar.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financa Publike për auditimin e raporteve financiare dhe raportit të deklarimit financiar të fushatës të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me kërkesën e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit të ndërmarr veprimet e nevojshme për të bërë thirrje të hapur për aplikim për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve të licencuar, të cilët do të auditojnë raportet vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike.
2. Mjetet buxhetore për përmbushjen e këtij obligimi nga ana e Kuvendit barten nga Buxheti i Kuvendit, por me mundësi rimbursimi me rastin e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit të Buxhetit, për vitin fiskal 2014.

2. Njoftimi i Komisionit Ad-hoc për punën në Reformën zgjedhore

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, Adem Grabovci, në emër të G/P të PDK-së, Ismet Beqiri, në emër të G/P të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të G/P të Lëvizjes Vetëvendosje, Ardian Gjini, në emër të G/P të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Komisioni Ad-hoc për Reformën Zgjedhore që të përgatisë Raportin e detajuar për punën e deri tanishme dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me këtë çështje.

3. Njoftimi i deputeteve për dorëheqje nga GP “Ardhmëria e Përbashkët”

Kryesia pasi, u njoftua me dorëheqjen e katër (4) deputetëve nga GP Zajednička Budućnost (Ardhmëria e Përbashkët), nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Grupi parlamentar Zajednička Budućnost (Ardhmëria e Përbashkët), i përbërë nga tetë (8) deputetë, nga data 23 janar 2014, nuk ekziston më, pasi që katër (4) deputetë kanë dhënë dorëheqje.

4. Njoftimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit për vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 9 deri me 12 dhjetor 2013

Kryesia u njoftua me vizitën zyrtare të realizuar nga Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, në Shqipëri, prej 9 deri me 12 dhjetor 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale